VENDIM
Nr.70, datë 12.10.2011

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA CREDINS SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43 shkronja "e", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 23 pikat 1 dhe 3, të nenit 24 pika 1 shkronja "ç", të nenit 54 pika 2 shkronja "dh" nënpika "v", të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga banka "Credins" sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

a) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valuator, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

i) letra me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Credins sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani